



Prishtinë, 12 shkurt 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1223_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 7 nënparagrafet 7.2, Nenit 16 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, Nenit 26 dhe Nenin 54 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Vendimin e Rregullatorit V_750_2015 për Aprovim të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- Nenin 1, paragrafin 4, nënparagrafin 4.2 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr. 07/2017);
- Kërkesën e KEDS për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë nga Rregullatori, të datës 05.11.2019.

Në seancën e mbajtur me datë 12 shkurt 2020, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A.)
- II. **Obligohet** KEDS që brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e aprovimit të Programit të Pajtueshmërisë së OSSH, të caktoj Zyrtarin e Pajtueshmërisë, sipas kërkesave të Nenit 5 të Programit të Pajtueshmërisë, dhe të dërgoj të dhënat e personit në Rregullator për aprovim nga Bordi i ZRRE-së.

Arsyetim

- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 16 korrik 2015 ka nxjerr vendimin V_750_2015 me të cilin ka aprovuar programin e pajtueshmërisë për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, i cili është zbatuar nga KEDS.
- o Rregullatori ka monitoruar Programin e Pajtueshmërisë sa herë që ka konsideruar të nevojshme, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kështu gjatë vitit 2019 ka konsideruar që ky program duhet amendamentuar nga KEDS.



- o Me datë 05.11.2019 KEDS ka dërguar në Rregullator draft Programin e Pajtueshmërisë të amendamentuar, të cilin ZRRE e ka analizuar vlerësuar dhe komentuar.
- o Pas inkorporimit të komenteve të ZRRE-së, KEDS me datë 23.01.2020 ka informuar Rregullatorin se nga ana e KEDS, ky program konsiderohet final. Programi duhet të aprovohet nga Bordi i Rregullatorit.
- o Rregullatori ka shqyrtuar kërkesën e KEDS për miratim të Programit të Pajtueshmërisë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- o Procedurat për ndryshim/plotësim të Programit të Pajtueshmërisë do të jenë të njëjta si për miratim të tij.
- o Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të raportoj në Rregullator në pajtim me Programin e Pajtueshmërisë së KEDS dhe dispozitat tjera të legjislacionit në fuqi.

III. Ky Program i Pajtueshmërisë shfuqizon "Programin e Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" (Programi i Pajtueshmërisë), i nxjerrë në Korrik 2015.

IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bashkëngjitur këtij vendimi është "**Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ("Programi i Pajtueshmërisë")**".

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KEDS SH.A dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, U.D. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izer Ruzhici, anëtar